

SHTOJCA 3 e

Parashtrimit prej Prokurorisë të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar

Publike



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE
ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR
SPECIJALIZOVANO TUŽILAŠTVO

Numri i lëndës: KSC-BC-2023-10
Prokurorja e Specializuar kundër Haxhi Shalës, Sabit Januzit dhe Ismet Bahtijarit

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Parashtrues: Zyra e Prokurorit të Specializuar

Data: 10 korrik 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publike

Version i Redaktuar Publik i Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar

Zyra e Prokurores së Specializuar

Kimberli P. Uest

Prokurorja e Specializuar, në përputhje me kompetencën që ka sipas neneve 35(2)(i) dhe 38(4) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji"), akuzon:

HAXHI SHALËN

SABIT JANUZIN

ISMET BAHTIJARIN

për **vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike dhe vepra penale kundër rendit publik** të ndëshkueshme në bazë të Kapitujve II, XXXI dhe XXXII të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Kodi nr. 06/L-074 (2019) ("KPK"), dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit, sikurse shtjellohet në vijim:

I. TË AKUZUARIT

1. **Haxhi SHALA** u lind më 17 mars 1970, në Banjë, Malishevë, Kosovë. Ai është shtetas i Kosovës [REDAKTUAR].
2. **Sabit JANUZI** u lind më 29 prill 1966, në Bërvenik, Kosovë. Ai është shtetas i Kosovës [REDAKTUAR].
3. **Ismet BAHTIJARI**, gjithashtu i njohur si "Shema", u lind më 27 shkurt 1963, në Fushticë të Poshtme, Kosovë. Ai është shtetas i Kosovës [REDAKTUAR].

II. PARAQITJE E FAKTEVE

A. Veprat penale të paraqitura në Aktakuzë

4. Të gjitha veprat penale të paraqitura në këtë aktakuzë kanë lidhje me procese zyrtare të Dhomave të Specializuara të Kosovës ("DHSK"), përfshirë hetimet e Zyrës së Prokurorit të Specializuar ("ZPS").

5. [REDAKTUAR] ("dëshmitari 1") është person që i ka dhënë ose ka të ngjarë t'i japë Task Forcës Hetimore Speciale ("TFHS"), ZPS-së dhe/ose cilitdo trupi gjykues të DHSK-së, informacion në lidhje me krime ose vepra penale të përfshira në juridiksionin e DHSK-së.

1) *Pengim i personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare*

6. **Haxhi SHALA, Sabit JANUZI dhe Ismet BAHTIJARI**, përmes kërcënimit të rëndë dhe veprimit të përbashkët të një grupi personash në të cilin ata morën pjesë, tentuan të pengonin persona zyrtarë, si gjykatës, prokurorë, zyrtarë të gjykatës, zyrtarë të prokurorisë apo persona të autorizuar nga gjykata ose prokuroria, në kryerjen e detyrave zyrtare.

7. Sikurse shtjellohet më poshtë, midis më së paku 5 prillit 2023 dhe 12 prillit 2023, **SHALA, JANUZI dhe BAHTIJARI**, në bashkëkryerje me njëri-tjetrin dhe individë të tjerë, u bashkërenduan si grup para dhe pas kontakteve personale të **JANUZIT dhe BAHTIJARIT** me dëshmitarin 1. Konkretisht, **JANUZI dhe BAHTIJARI**, të udhëzuar nga **SHALA**, u takuan secili më vete me dëshmitarin 1 për ta nxitur dëshmitarin 1 që të tërhiqte dëshminë, ose të mos jepte dëshmi në proceset zyrtare në DHSK. Kjo sjellje tregon qartë synimin e **SHALËS, JANUZIT dhe BAHTIJARIT** për të dëmtuar dhe penguar persona zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare.

Kontakti i parë

8. Më 5 prill 2023, **SHALA** i telefonoi **JANUZIT**. Më pas edhe **BAHTIJARI** i telefonoi **JANUZIT**.

9. Pasi i telefonoi dhe u sigurua që dëshmitari 1 ishte në shtëpi, **BAHTIJARI** shkoi në shtëpinë e dëshmitarit 1. **BAHTIJARI** i tha dëshmitarit 1 se **SHALA** e kishte kontaktuar kohët e fundit dhe e kishte dërguar që t'i thoshte dëshmitarit 1 se duhej të tërhiqte dëshminë.

10. Kur dëshmitari 1 e pyeti nëse ai vetë ose djali i tij do të vriteshin në qoftë se dëshmitari 1 do të jepte dëshmi, **BAHTIJARI** e konfirmoi këtë.
11. **BAHTIJARI** u largua nga shtëpia e dëshmitarit 1 dhe eci deri te një veturë aty afër, në të cilën po prisnin dy burra dhe një person i tretë në ulësen e shoferit.
12. Si rezultat i këtij kontakti, dëshmitari 1 u shqetësua për sigurinë e familjes së vet.
13. Më vonë më 5 prill 2023, pasi **BAHTIJARI** kishte vizituar dëshmitarin 1, **SHALA** dhe **JANUZI**, si dhe **JANUZI** dhe **BAHTIJARI** individualisht, patën kontakte të shumta me mesazhe dhe telefon, ku përfshihen edhe kontaktet midis **SHALËS** dhe **JANUZIT** për bashkërendimin e një takimi personal atë natë.
14. Gjatë ditëve në vijim, **SHALA** dhe **JANUZI**, ndër të tjerë, mbetën në kontakt dhe u lidhën përmes telefonit së paku katër herë midis 6 prillit dhe 9 prillit 2023.

Kontakti i dytë

15. Më 12 prill 2023, pak pasi i kishte telefonuar **SHALËS**, **JANUZI** shkoi në shtëpinë e dëshmitarit 1. Në shtëpinë e dëshmitarit 1, **JANUZI** i tha dëshmitarit 1 se **SHALA** i kishte kërkuar **JANUZIT** të vinte aty në vijim të vizitës së **BAHTIJARIT** për të mësuar se çfarë planifikonte të bënte dëshmitari 1 dhe si mund të zgjidhej çështja e dëshmisë së tij.
16. Konkretisht, **JANUZI** i tha dëshmitarit 1 se **SHALA** i kishte kërkuar **JANUZIT** që të përcillte mesazhin se, nëse dëshmitari 1 do të tërhiqte dëshminë, **SHALA** dhe persona të tjerë të papërmendur me emra do t'i ofronin "ndihmë". Dëshmitari 1 u përgjigj se, në qoftë se **SHALA** dhe/ose të tjerët do t'i jepnin atij 200.000 euro, do të arrihej ujdia.
17. Dëshmitari 1 nuk konfirmoi apo mohoi se ishte dëshmitar. **JANUZI** tha që do t'u tregonte 'atyne' se çfarë kishte thënë dëshmitari 1.

18. Pak pas vizitës së 12 prillit 2023 që i bëri dëshmitarit 1, **JANUZI** i telefonoi sërish **SHALËS**.

19. Si rezultat i kontaktit të dytë, dëshmitari 1 u shqetësua edhe më shumë për sigurinë e vet dhe të familjes.

20. **SHALA, JANUZI** dhe **BAHTIJARI** (i) i krijuan frikë dhe shqetësime të rënda një personi - dëshmitarit 1 - i cili i ka dhënë ose ka të ngjarë t'i japë informacion TFHS-së, ZPS-së dhe/ose cilitdo trupi gjykues të DHSK-së për krimet ose veprat penale të përfshira në juridiksionin e DHSK-së, që përbën një faktor të fortë shkurajues për dhënien e informacioneve (të mëtejshme) nga ky person lidhur me krimet e përfshira në juridiksionin e DHSK-së; (ii) rrezikuan aftësinë e DHSK-së/ZPS-së për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimet në mënyrë efektive, ndër të tjera përmes marrjes dhe mbrojtjes së dëshmive relevante të dëshmitarëve; dhe (iii) ndikuan që ZPS-ja t'i devijonte mjetet e burimet dhe kohën e vet, për të trajtuar pasojat faktike dhe të mundshme për dëshmitarin 1 dhe familjen e tij në lidhje me proceset zyrtare të DHSK-së.

21. Sa i përket ndikimit mbi kohën dhe mjetet e burimet e ZPS-së dhe DHSK-së, këtu përfshihen: angazhimi i një numri punonjësish të ZPS-së dhe DHSK-së në kontakte shtesë të panevojshme me dëshmitarin 1, për të garantuar sigurinë dhe aftësinë e dëshmitarit 1 për të dëshmuar; shpenzimi i mjeteve dhe burimeve të ZPS-së për hetimin e ngjarjeve të shtjelluara në këtë Aktakuzë; dhe shpenzimi i kohës dhe i mjeteve e burimeve të ZPS-së dhe DHSK-së për marrjen e masave të reja të sigurisë.

22. Sikurse shtjellohet në paragrafët 8 deri 19 më lart, **SHALA, JANUZI** dhe **BAHTIJARI** kishin synimin dhe dijeninë e nevojshme për veprat penale të (i) pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, përmes kërcënimit të rëndë dhe (ii) pjesëmarrjes në një grup personash i cili, përmes veprimit të përbashkët, tentoi të pengonte persona zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare.

2) *Frikësimi gjatë procedurës penale*

23. Midis më së paku 5 prillit 2023 dhe 12 prillit 2023, **SHALA, JANUZI** dhe **BAHTIJARI** përdorën dhe tentuan të përdornin kërcënimin e rëndë ose ndonjë mënyrë tjetër të detyrimit, premtimin për dhuratë ose ndonjë formë tjetër përfitimi për të nxitur personin tjetër, dëshmitarin 1, që të mos jepte deklaratë, ose të jepte deklaratë të rreme, ose të mos i jepte informacion të vërtetë policisë, prokurorit ose gjykatësit, kur ai informacion ka të bëjë me pengimin e procedurës penale. Veprimet e **SHALËS, JANUZIT** dhe **BAHTIJARIT** tregojnë qartë synimin e tyre për të frikësuar dëshmitarin 1 dhe për të nxitur dëshmitarin 1 që të tërhiqte dëshminë ose të mos jepte dëshmi në procese zyrtare të DHSK-së.

24. Konkretisht, sikurse shtjellohet në paragrafët 8 deri 19 (të përfshirë plotësisht këtu përmes referencave):

- i. Më 5 prill 2023, me udhëzim të **SHALËS, BAHTIJARI** kontaktoi dëshmitarin 1 dhe (i) i tha dëshmitarit 1 se dëshmitari 1 duhej të tërhiqte dëshminë në proceset e DHSK-së, dhe (ii) i konfirmoi dëshmitarit 1 se po të mos e bënte këtë, kjo mund të rezultonte në vrasjen e dëshmitarit 1 ose të djalit të dëshmitarit 1.
- ii. Më 12 prill 2023, me udhëzim të **SHALËS, JANUZI** kontaktoi dëshmitarin 1 në vijim të kontaktit të mëhershëm të **BAHTIJARIT** për t'i komunikuar dëshmitarit ofertën se **SHALA** dhe persona të tjerë të papërmendur me emra do ta ndihmonin dëshmitarin 1 nëse ai pranonte të tërhiqte dëshminë e tij.
- iii. Para dhe pas kontakteve të tyre me dëshmitarin 1, **JANUZI** dhe **BAHTIJARI** komunikuan dhe bashkërenduan me njëri-tjetrin dhe me **SHALËN**.

25. Sikurse shtjellohet në paragrafët 8 deri 19 më lart, **SHALA, JANUZI** dhe **BAHTIJARI** kishin synimin dhe dijeninë e nevojshme për veprën penale të frikësimit gjatë procedurës penale.

B. Format e përgjegjësisë penale

26. Përmes veprimeve të përshkruara më lart, **SHALA, JANUZI** dhe **BAHTIJARI** mbajnë përgjegjësi penale individuale për kryerje ose tentativë për kryerjen e secilës prej veprave penale të paraqitura në këtë aktakuzë, përmes formave të përgjegjësisë penale të renditura në vijim. Ata kishin dijeninë dhe synimin e nevojshëm për secilën formë të përgjegjësisë penale dhe secilën vepër penale.

1) Kryerja dhe tentativa

27. **SHALA, JANUZI** dhe **BAHTIJARI** kryen veprën penale të paraqitur në Pikën 3 përmes veprimeve të përshkruara më lart, sipas nenit 17(1) të KPK-së. Për **SHALËN**, ndër këto veprime përfshihen ato të renditura në paragrafët 8-11, 13-18 dhe 24 (i)-(iii) më lart. Për **JANUZIN** ndër këto veprime përfshihen ato të renditura në paragrafët 13-18 dhe 24 (i)-(iii) më lart. Për **BAHTIJARIN** ndër këto veprime përfshihen ato të renditura në paragrafët 8-11, 13 dhe 24 (i)-(iii) më lart

28. Gjithashtu, ose si alternativë, përmes këtyre veprimeve, **SHALA, JANUZI** dhe **BAHTIJARI** tentuan, sipas nenit 28 të KPK-së, të kryenin veprat penale të paraqitura në Pikën 1 dhe Pikën 2. Për **SHALËN**, ndër këto veprime përfshihen ato të renditura në paragrafët 8-11, 13-18 dhe 24 (i)-(iii) më lart. Për **JANUZIN** ndër këto veprime përfshihen ato të renditura në paragrafët 13-18 dhe 24 (i)-(iii) më lart. Për **BAHTIJARIN** ndër këto veprime përfshihen ato të renditura në paragrafët 8-11, 13 dhe 24 (i)-(iii) më lart.

2) Bashkëkryerja dhe marrëveshja për të kryer vepër penale

29. Përmes veprimeve të përshkruara më lart, **SHALA, JANUZI dhe BAHTIJARI** (i) kryen bashkërisht veprat penale të paraqitura në Pikën 1 dhe Pikën 3 përmes bashkëkryerjes, sipas nenit 31 të KPK-së, duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose duke kontribuar konsiderueshëm në kryerjen e saj në ndonjë mënyrë tjetër, dhe/ose (ii) sipas nenit 35 të KPK-së, u morën vesh për të kryer veprat penale, dhe një apo më shumë prej personave që ishin pjesë e asaj marrëveshjeje ndërmorën veprime të konsiderueshme për kryerjen e veprës penale. **SHALA, JANUZI dhe BAHTIJARI** kontribuan konsiderueshëm dhe ndërmorën veprime të konsiderueshme për kryerjen e veprave penale, në realizimin e qëllimit ose marrëveshjes së përbashkët, ndër të tjera nëpërmjet njëres apo më shumë prej mënyrave të mëposhtme, sikurse përshkruhet me më shumë hollësi në paragrafët 8 deri 19 më lart:

- a. duke udhëzuar, bashkërenduar dhe/ose marrë pjesë në kontakte dhe takime me dëshmitarin 1, person për të cilin besonin se i kishte dhënë ose kishte të ngjarë t'i jepte dëshmi DHSK-së/ZPS-së;
- b. duke i bërë presion dëshmitarit 1 që të tërhiqte deklaratën, të jepte informacion të rremë, ose të mos jepte dëshmi;
- c. duke udhëzuar, bashkërenduar dhe/ose marrë pjesë në kontakte dhe takime me dëshmitarin 1 duke përdorur sjellje dhe gjuhë kërcënuese për ta frikësuar dëshmitarin 1; dhe
- d. duke udhëzuar, bashkërenduar dhe/ose marrë pjesë në kontakte me dëshmitarin 1 kundër dëshirës së tij, ndër të tjera përmes telefonit dhe takimeve personale.

30. Për **SHALËN**, ndër këto veprime përfshihen ato të renditura në paragrafët 8-11, 13-18 dhe 24 (i)-(iii) më lart. Për **JANUZIN** ndër këto veprime përfshihen ato të renditura në paragrafët 8, 13-18 dhe 24 (i)-(iii) më lart. Për **BAHTIJARIN** ndër këto veprime përfshihen ato të renditura në paragrafët 8-11, 13, 15 dhe 24 (i)-(iii) më lart

3) *Ndihma*

31. Së fundi, përmes një apo më shumë prej veprimeve të përshkruara në paragrafët 8 deri 19 më lart, **SHALA, JANUZI** dhe **BAHTIJARI** ndihmuan njëri-tjetrin dhe persona të tjerë në kryerjen e veprave penale. Për **SHALËN**, ndër këto veprime përfshihen ato të renditura në paragrafët 8-11, 13-18 dhe 24 (i)-(iii) më lart. Për **JANUZIN** ndër këto veprime përfshihen ato të renditura në paragrafët 8, 13-18 dhe 24 (i)-(iii) më lart. Për **BAHTIJARIN** ndër këto veprime përfshihen ato të renditura në paragrafët 8-11, 13, 15 dhe 24 (i)-(iii) më lart

III. PARAQITJE E VEPRAVE PENALE

32. Përmes veprimeve të përshkruara më lart, **SHALA, JANUZI** dhe **BAHTIJARI** kryen ose tentuan të kryenin, vetëm, në bashkëkryerje dhe/ose në marrëveshje, veprat penale të paraqitura në këtë aktakuzë, dhe/ose ndihmuan kryerjen e tyre.

33. **SHALA, JANUZI** dhe **BAHTIJARI** mbajnë përgjegjësi penale individuale për:

Pika 1: PENGIM TË PERSONAVE ZYRTARË NË KRYERJEN E DETYRAVE ZYRTARE, me anë të kërcënimit të rëndë, midis më së paku 5 dhe 12 prillit 2023, VEPËR PENALE KUNDËR RENDIT PUBLIK, e ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 21, 28, 31, 33, 35 dhe 401(1) dhe (5) të KPK-së, dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit;

Pika 2: PENGIM TË PERSONAVE ZYRTARË NË KRYERJEN E DETYRAVE ZYRTARE, me anë të pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi, midis më së paku 5 dhe 12 prillit 2023, VEPËR PENALE KUNDËR RENDIT PUBLIK, e ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 21, 28, 33, 35, dhe 401(2) dhe (5) të KPK-së, dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit; dhe

Pika 3: FRIKËSIM GJATË PROCEDURËS PENALE, midis më së paku 5 dhe 12 prillit 2023, VEPËR PENALE KUNDËR ADMINISTRIMIT TË DREJTËSISË DHE

ADMINISTRATËS PUBLIKE, e ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 21, 31, 33, 35 dhe 387 të KPK-së, dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit.

Të gjitha pjesët e kësaj aktakuze duhen lexuar në lidhje me njëra-tjetrën.

/nëshkrimi/

Kimberli P. Uest

Prokurore e Specializuar

E mërkurë, 10 korrik 2024

Në Hagë, Holandë.